



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Be New LLC" të datës 03.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP - Dollap Metalik" me nr. të prokurimit 616-24-1180-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Be New LLC" të datës 03.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP - Dollap Metalik" me nr. të prokurimit 616-24-1180-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Be New LLC" (tutje "parashtruesi") me datë 03.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP - Dollap Metalik" me nr. të prokurimit 616-24-1180-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi nr. 1 - *“OE i rekomanduar per kontrate nuk ka prezantuar raportin testues SVHC per produktin e ofertuar,ashtu siç është kerkuar ne dosjen e tenderit”*.

Pretendimi nr. 2 - *“Duke u bazuar ne certifikata ISO te prezantuara nga OE i rekomanduar , konsiderojme se ne baze certifikatat ISO ne gjuhen Angleze dhe Kineze , ka ndryshime dmth nuk behet fjale per kompani te njejte pasi qe ne gjuhen angleze Loyang Dbin Office Furniture Co.,Ltd (certifikata ne gjuhen angleze) dhe Loyang Shuangbin Office Furniture Co.,Ltd (certifikatat ne gjuhen Kineze), andaj kjo konfirmon qarte se behet fjale per dy prodhues te ndryshem dhe jo per nje prodhues”*.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 1 - komisioni vlerësues ka analizuar me kujdes raportin testues SVHC të dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar dhe ka gjetur se ky dokument si i tillë është në përputhje të plotë me kërkesën e dosjes së tenderit. Vlen të thuhet se as parashtruesi nuk e konteston faktin se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar raportin SVHC mirëpo e konteston faktin nëse përmbajtja e këtij dokumenti është sipas kërkesës së DT. Komisioni vlerësues ka marrë parasysh mënyrën si është formuluar kërkesa në SVHC dhe ka gjetur se në DT nuk është kërkuar që raport të ketë ose të mos ketë përmbajtjen e caktuar sikurse pretendohet nga parashtruesi. Prandaj AK i ka falur besimin e plotës të gjetura të komisionit vlerësues dhe në këtë mënyrë është konstatuar se pretendimi ankimor i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 2 – parashtruesi nuk e konteston faktin që tenderuesi i rekomanduar i ka dorëzuar çertifikatat ISO mirëpo vetëm e konteston faktin nëse përmbajtja e këtyre certifikatave në gjuhën angleze nuk përputhet me përmbajtjen në versionin në gjuhën kineze. Sidoqoftë kjo çështje është sqaruar me disa vendime të ndryshme të OSHP. Mirëpo përtej kësaj sipas LPP nenit 13 par. 4, dokumentet që i dorëzon një tenderues të cilat nuk janë në gjuhën shqipe, angleze ose serbe nuk merren parasysh nga AK. Rrjedhimisht komisioni vlerësues se dorëzimi i certifikatave vetëm në gjuhën angleze është e mjaftueshme për të përmbushur kërkesën e DT. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor kundër tenderuesve të tjerë, është gjetur se tenderuesit e tjerë në këtë aktivitet të prokurimit janë shpallur si të pasuksesshëm. Prandaj parashtruesi nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se *“Palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Përmes nenit 59 paragrafit 1 të RRPP është përcaktuar se *“kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar...”*. Në këtë mënyrë është gjetur se nuk janë përmbushur kushtet për të parashtruar kërkesën për rishqyrtim në kuptim të nenit 59 paragrafit 1 të RRPP për

shkak se parashtruesi nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP.

Vlen të shtohet se parashtruesi në rastin konkret ka dorëzuar ofertë me çmim dukshëm më të lartë sesa tenderuesi i rekomanduar për këtë kontratë.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 12.08.2024

Visar SHEHU
UDHËHEQËS I SEKTORIT TË PROKURIMIT
KOMUNA E PRISHTINËS



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.